



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2024:236379

Datë: 11.12.2024

Numri i dokumentit: 06579648

C.nr.3349/24

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Jeton Zymeri, në çështjen juridike kontestimore të paditësit H.M nga Vushtrria, të cilin e përfaqëson V.U avokat nga Vushtrria, rruga “...” nr.22, kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, me objekt kontesti pagesa mbi bazën e kualifikimit arsimor, me vlerë të kontestit 2,670.00 euro, jashtë seance me datë 11.12.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET E TËRHEQUR padia C.nr.3349/24 e datës 26.08.2024, e paditësit H.M nga Vushtrria, kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, për pagesën mbi bazën e kualifikimit arsimor, për shkak të mos pagesës së taksës gjyqësore shtesë në shumën prej 20 euro.

A r s y e t i m

Paditësi H.M nga Vushtrria, të cilin e përfaqëson V.U avokat nga Vushtrria, rruga “...” nr.22, pranë kësaj gjykate me datë 26.08.2024, ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Arsim, për pagesën mbi bazën e kualifikimit arsimor në shumën prej 2,670.00 euro. Me datë 28.08.2024, paditësi kishte paguar taksën gjyqësore në shumën prej 20 euro.

Me nenin 12 pika 12.1 të Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, përcaktohet se *për kërkesat nga 2,501.00 euro e deri në 5,000.00 euro, duhet të paguhet taksa në shumën prej 40.00 euro.*

Me aktvendimin e datës 20.11.2024, gjykata përmes përfaqësuesit të tij, e ka ftuar paditësin që në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së aktvendimit, ta bëjë pagesën e taksës gjyqësore shtesë në shumën prej 20 euro, me paralajmërimin se nëse nuk paguhet taksa shtesë, padia do të konsiderohet e tërhequr.

Përfaqësuesi i paditësit me datë 27.11.2024, e ka pranuar Aktvendimin për pagesën e taksës shtesë, por edhe pas kalimit të afatit, nuk e ka bërë pagesën e taksës shtesë.

Gjykata, në këtë rast nuk gjeti se ekzistojnë konditat për lirim të paditësit nga pagesa e taksës gjyqësore shtesë, andaj konform nenit 253 par.5 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

C.nr.3349/24, me datë 11.12.2024

Gj y q t a r i

Jeton Zymeri

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.